

Options in Aged Care

Mundësitë brenda Kujdesit për të Moshuarit



English / Albanian



This information was compiled by the Centre for Cultural Diversity in Ageing 2008.

Ky informacion u hartua nga Qendra për Diversitetin Kulturor në Plakje (Centre for Cultural Diversity in Ageing) 2008.

©Centre for Cultural Diversity in Ageing 2008.

## Options in Aged Care

There are many types of aged care services, but finding out what options are available to you or your family member can be confusing. This information provides an overview of aged care services and how you can access them, along with some useful contact numbers. It describes three types of government-subsidised aged care services:

- **Community Care**
- **Respite Care**
- **Residential Care**

Even if you do not require these services now, it is important to know what is available so you can plan for any care needs that you may have in the future.

## Mundësitë brenda Kujdesit për të Moshuarit

Ka shumë lloje shërbimesh të kujdesit për të moshuarit, por që të mësoni se cilat janë mundësitë më të mira për ju dhe familjen tuaj nuk është e lehtë. Ky informacion ju jep një përmbledhje të shërbimeve ekzistuese, si mund t'i merrni ato dhe disa numra të dobishëm kontakti. Aty gjithashtu përshkruhen edhe tre llojet e shërbimeve të kujdesit për të moshuarit që operojnë me fondet e qeverisë. Ato janë:

- **Kujdesi në Komunitet (Community Care)**
- **Pushimi nga Kujdesja (Respite Care)**
- **Kujdesi për të Moshuarit (Residential Care)**

Edhe pse për momentin ju mund të mos keni nevojë për këto shërbime, është mirë që të keni dijeni për to në mënyrë që të planifikoni për të ardhmen dhe nevojat që mund të dalin atëherë.

## Community Care

Most older people prefer to continue living in their own home, but some people may find this difficult to do without assistance. There are a number of aged care services that help older people to continue living in their own home. This type of care is known as 'Community Care' and there are four different options, depending on your needs:

### Home and Community Care (HACC)

Home and Community Care provides basic support services for frail aged people who are experiencing difficulties managing daily tasks but who wish to continue living independently at home.

Services may include: nursing and allied health services, personal care (assistance with bathing, dressing and eating), Meals on Wheels and other food services, home help (assistance with housework, laundry and shopping), home modification and maintenance, transport, counselling and social support. Home and Community Care services are usually provided by local councils, community health centres and community organisations.

## Kujdesi në Komunitet (Community Care)

Shumë të moshuar parapëlqejnë që të jetojnë në shtëpinë e tyre, por ka disa prej tyre që nuk mund t'a bëjnë një gjë të tillë pa patur ndihmë. Për këtë ka një sërë shërbimesh për të moshuarit që i ndihmojnë ata që të jetojnë në shtëpinë e tyre. Ky lloj kujdesi quhet 'Kujdes në Komunitet' dhe brenda tij ka katër mundësi në varësi të nevojave tuaja:

### Kujdesi në Shtëpi dhe Komunitet (Home and Community Care - HACC)

Kujdesi në Shtëpi dhe Komunitet i jep të moshuarve në gjendje delikate shërbimet bazë kur ata e kanë të vështirë që të kryejnë detyrat e përditshme por që pavarësisht nga kjo duan që të vazhdojnë dhe të jetojnë në shtëpinë e tyre.

Këto shërbime mund të jenë: shërbimet e infermierëve dhe ato të shëndetit dytësor, shërbimet vetjake (ndihmë me larjen, veshjen dhe ngrënien), sjellja e ushqimit të përgatitur në shtëpi dhe shërbime të tjera të ushqimit, ndihmë me punët e shtëpisë, larjen e rrobave dhe pazarin, ndihmë me mirëmbajtjen dhe rregullimin e shtëpisë, transportin, këshillimin dhe ndihmën sociale. Kujdesi në Shtëpi dhe Komunitet zakonisht jepet nga organizata komunale, qendra të shëndetit të komunitetit ose organizata komunitare.

## Community Aged Care Packages (CACP)

Community Aged Care Packages provide services to frail aged people with more complex care needs, or who require a greater range of services to help them continue living at home.

The packages of services are flexible and designed to suit individual needs, and may include: personal care (assistance with bathing, dressing and eating), meal preparation, home help (assistance with housework, laundry and shopping), gardening, transport and social support. These services are planned and coordinated by an approved aged care service provider. Eligibility for Community Aged Care Packages is determined by an *Aged Care Assessment Team* (see page 9).

## Extended Aged Care at Home Packages (EACH)

Extended Aged Care at Home Packages provide services to people who need more help than a Community Aged Care Package can provide.

The packages of services are flexible and designed to suit individual needs, and may include: nursing and allied health services, personal care (assistance with bathing, dressing and eating), home help (assistance with housework, laundry and shopping), transport and social support. These services are planned and coordinated by an approved aged care service provider. Eligibility for Extended Aged Care at Home Packages is determined by an *Aged Care Assessment Team* (see page 9).

## Paketat e Shërbimeve të Ndhmës Komunitare për të Moshuar (Community Aged Care Packages - CACP)

Paketat e Shërbimeve të Ndhmës Komunitare për të Moshuar u japin shërbime personave që janë të dobët fizikisht dhe që kanë nevoja më komplekse, ose atyre personave që kanë nevojë për më shumë shërbime kur jetojnë në shtëpi. Paketat me shërbime nuk janë të ngrira dhe krijohen sipas nevojave të individit.

Ato mund të përbëhen nga: kujdesi personal (ndihmë me larjen, veshjen dhe ngrënien), përgatitjen e ushqimeve, ndihmën në shtëpi, (ndihmë me punët e shtëpisë, larjen e rrobave dhe bërjen e pazarit), mbajtjen e kopshti transportin dhe ndihmën shoqërore. Këto shërbime planifikohen dhe drejtohen nga një shërbim i kujdesit për të moshuar që ka miratimin e duhur. Pasja ose jo e të *Drejtës për të Marrë Paketat e Shërbimeve të Ndhmës Komunitare për të Moshuar*, vendoset nga *Grupi i Vlerësimit të Kujdesit për të Moshuar* (shih faqen 9).

## Paketat e Ndhmës Intensive në Banesat për të Moshuarit (Extended Aged Care at Home Packages - EACH)

Paketat e Ndhmës Intensive në Banesat për të Moshuarit japin shërbime për ata njerëz që kanë nevojë për më shumë ndihmë se sa ndihma që jep Shërbimi i Ndhmës Komunitare për të Moshuarit. Këto ndihma mund të ndryshohen sipas dëshirave dhe nevojave individuale, dhe mund të përfshijnë: infermirere/ë, Shërbimet Bashkë-sanitare, kujdesin personal (ndihmë me larjen, veshjen dhe ngrënien), ndihmë në shtëpi (ndihmë me punët e shtëpisë, larjen e rrobave dhe pazarin), transport dhe ndihmë sociale. Këto shërbime planifikohen dhe koordinohen nga një dhënës i miratuar i kujdesit për të moshuar. Nëse një person ka apo jo të drejtë që të marrë *Ndhmë Intensive në Banesat për të Moshuarit*, këtë e vendos *Grupi i Vlerësimit të Kujdesit për të Moshuarit* (shih faqen 9).

## Extended Aged Care at Home Packages Dementia (EACH D)

Extended Aged Care at Home Packages Dementia provide services to people living with dementia. The packages of services are flexible and designed to suit individual needs, and may include: nursing and allied health services, personal care (assistance with bathing, dressing and eating), home help (assistance with housework, laundry and shopping), transport and social support.

These Services are planned and coordinated by an approved aged care service provider. Eligibility for Extended Aged Care at Home Packages Dementia is determined by an *Aged Care Assessment Team* (see page 9).

For more information about Community Care and how to find a service that meets your needs, call the **Commonwealth Carelink Centre** on **1800 052 222**.

## Paketat e Ndhmës Intensive për të Moshuarit në Shtëpi- Demenca (Extended Aged Care at Home Packages Dementia - EACH D)

Paketat e Ndhmës Intensive për të Moshuarit në Shtëpi- Demenca u shërbejnë njerëzve që vuajnë nga demenca. Këto ndihma mund të ndryshohen sipas dëshirave dhe nevojave individuale, dhe mund të përfshijnë: infermirere/ë, Shërbimet Bashkë-sanitare, kujdesin personal (ndihmë me larjen, veshjen dhe ngrënien), ndihmë në shtëpi (ndihmë me punët e shtëpisë, larjen e rrobave dhe pazarin), transport dhe ndihmë sociale.

Këto shërbime planifikohen dhe koordinohen nga një dhënës i miratuar i kujdesit për të moshuar. Në se një person ka apo jo të drejtë që të marrë Ndhmë Intensive për të Moshuarit në Shtëpi- Demenca, këtë e vendos Grupi i Vlerësimit të Kujdesit për të Moshuarit (shih faqen 9).

Në se dëshironi më shumë të dhëna për Ndhmën Komunitare dhe se si mund të gjeni një shërbim që i përshtatet nevojave tuaja, ju mund të telefononi tek **Qendra e Komunitetit për Ndhmën e Kujdestarëve (Commonwealth Carelink Centre)** në **1800 052 222**.

## Respite Care

Respite Care is short-term care, which enables the older person and their carer to have a break from their normal routine. Many older people are cared for by family members at home. It is important that carers are supported in this valuable role, especially as many carers are themselves elderly. Respite Care supports the carer to have a break from their caring responsibilities, while also helping the older person to continue living at home.

Respite Care provides care services to the older person on a temporary basis, which enables the carer to rest, attend to other responsibilities (eg shopping), or to have a holiday. It is usually planned in advance, but may be arranged in an emergency (eg if the carer is unwell).

Respite care may also be accessed by older people who live on their own and feel unable to look after themselves and need a break. It can be provided in the older person's home, in day-care centres or in Residential Care. Respite Care is provided through Home and Community Care, the National Respite for Carers Program and Residential Care. Access to Respite Care is based on eligibility, priority and need.

For more information about Respite Care and other support services for carers, call the **Commonwealth Carers' Respite Centre** on **1800 059 059**.

## Pushim nga Kujdesja (Respite Care)

Pushim nga Kujdesja quhet kujdesja për një kohë të shkurtër që i jepet të moshuarit në mënyrë që i moshuari dhe personi që kujdeset për të në përgjithësi të marrin pak pushim nga rutina e tyre e përditshme. Shumë njerëz kujdesen për të moshuarit në shtëpi. Prandaj ka rëndësi që edhe kujdestarët të marrin ndihmën e nevojshme në këtë rol të madh që luajnë, sidomos kur edhe kujdestarët vetë janë të moshuar. Pushimi nga Kujdesja e ndihmon kujdestarin të pushojë dhe në të njëjtën kohë e lejon të moshuarin që të vazhdojë të jetojë në shtëpi për atë periudhë kur kujdestari pushon.

Pushimi nga Kujdesja jep kujdesje për të moshuarin përkohësisht, i jep mundësi kujdestarit të çlodhet, t'i kushtojë vëmendje përgjegjësive të tjera që mund të ketë (p.sh. të bëjë pazarin), ose të shkojë për pushime. Zakonisht ky lloj kujdesi planifikohet që më përpara, por mund të porositet edhe në rast urgjence (p.sh. në rast se kujdestari sëmuret).

Pushimi nga Kujdesja u jepet edhe atyre personave të moshuar që jetojnë vetëm, që nuk mund të kujdesen për vehten dhe kanë nevojë për një pushim. Ky kujdes jepet ose në shtëpinë e të moshuarit, ose në një qendër të kujdesit ditor ose në Banesat e Kujdesit për të Moshuarit. Pushimi nga Kujdesja jepet nëpërmjet Kujdesit në Shtëpi dhe Komunitet (Home and Community Care), Programit Kombëtar të Pushimit për Kujdestarët (National Respite for Carers Program) dhe Kujdesit për të Moshuar (Residential Care). Dhënia apo jo e Pushimit për Kujdestarë varet nga plotësimi i kriterëve, prioriteti dhe nevoja.

Në se dëshironi më shumë të dhëna për Pushimin nga Kujdesja dhe shërbime të tjera ndihme për kujdestarët, ju mund të telefononi tek **Qendra e Komonuelthit për Pushimin e Kujdestarëve (Commonwealth Carers' Respite Centre)** në **1800 059 059**.

## Residential Care

As an older person's level of frailty increases, it may no longer be an option for them to continue living in their own home and an aged care home may need to be considered. Aged care homes are also known as 'Residential Care'.

There are two types of Residential Care: low-level care and high-level care. Both levels of care provide a range of specified services, including: accommodation, basic furnishings, laundry, cleaning, meals and refreshments, staff to help at all times, personal care (assistance with bathing, dressing and eating), occasional nursing care and social activities.

High-level care is designed for people who are very frail, require 24-hour assistance and on-going nursing care. Some aged care homes provide low-level care and high-level care, enabling people to stay in the same home even if their care needs change. This is known as 'ageing in place'. Aged care homes are run by approved aged care service providers. Eligibility for Residential Care is determined by an *Aged Care Assessment Team* (see page 9).

For more information about Residential Care and how to find a home that meets your needs, call the **Commonwealth Carelink Centre** on **1800 052 222** or the **Aged Care Information Line** on **1800 500 853**.

## Kujdesi për të Moshuarit (Residential Care)

Kur një i moshuar fillon që të ndjehet gjithnjë edhe më i dobët, për atë bëhet më e vështirë që të jetojë në shtëpinë e tij, dhe në këtë rast jeta në një shtëpi të kujdesjes për të moshuarit mund të jetë zgjidhja më e përshtatshme. Shtëpitë e kujdesit për të moshuarit quhen shkurt Kujdesi për të Moshuarit.

Kujdesi për të Moshuarit mund të jepet në dy mënyra: në nivel të ulët dhe në nivel të lartë. Që të dy këta lloje kujdesi ofrojnë një numër shërbimesh specifike, përfshi: banesa, mobilim bazë, lavanderi, pastrim, ushqime dhe pije, ndihmën e personelit në çfarëdolloj kohe, ndihmë me nevojat personale (ndihmë me larjen, veshjen dhe ngrënien), ndihmën e infermiereve sipas rastit dhe aktivitete shoqërore.

Kujdesi i nivelit të lartë u jepet atyre personave që janë shumë të dobët, që kanë nevojë për ndihmë 24 orëshe dhe kujdes të vazhdueshëm prej infermiereve. Disa shtëpi të kujdesit për të moshuarit janë në gjendje që të ofrojnë kujdes të të dyja llojeve. Në këtë mënyrë i moshuari nuk ka nevojë që të largohet në rast se natyra apo sasia e shërbimit që ai kërkon ndryshon drejt rritjes. Ky proces quhet ndryshe 'Plakja në të njëjtën banesë për kujdesin e të moshuarve'. Në se një person ka apo jo të drejtë që të marrë Kujdes për të Moshuarit, këtë e vendos *Grupi i Vlerësimit të Kujdesit për të Moshuarit* (shih faqen 9).

Në se dëshironi më shumë të dhëna për Kujdesin për të Moshuarit dhe se si mund të gjeni një banesë që i plotëson të gjitha nevojat tuaja, ju mund të telefononi tek **Qendra e Komunitetit për Ndihmën e Kujdestarëve (Commonwealth Carelink Centre)** në **1800 052 222** ose tek **Linja e Informacionit për Kujdesin e të Moshuarve (Aged Care Information Line)** në **1800 500 853**.

## Additional Information

### Aged Care Assessment Team (ACAT)

The first step in accessing most government-subsidised aged care services is to receive an assessment by the Aged Care Assessment Team (ACAT). Eligibility for Community Aged Care Packages, Extended Aged Care at Home Packages and Residential Care is determined by an ACAT assessment, which determines eligibility by assessing a person's needs.

This is a free and confidential service, and the process is not as daunting as it may sound. An ACAT representative (usually a doctor, nurse, social worker or other health care professional) will assess your situation and specific care needs.

You will be informed about the services you are eligible to receive and how to find a service that meets your needs. You may choose to have a relative or friend with you during the assessment. You also have the right to ask ACAT to provide an interpreter. If you are not satisfied with the outcome of the assessment, you have the right to appeal the decision. To arrange an ACAT assessment, you can ask your doctor for a referral or call the Commonwealth Carelink Centre on 1800 052 222.

## Informacione Shtesë

### Grupi i Vlerësimit të Kujdesit për të Moshuarit (Aged Care Assessment Team - ACAT)

Hapi i parë drejt hyrjes në shumicën e shtëpive për kujdesin e të moshuarve të administruara nga qeveria është vlerësimi i kryer nga Grupi i Vlerësimit të Kujdesit për të Moshuarit (ACAT). ACAT vendos nëse një person ka të drejtë që të marrë Paketat e Ndhmës Komunitare për të Moshuar, Paketat e Ndhmës Intensive në Banesat për të Moshuarit dhe Kujdesin për të Moshuarit.

Kjo bëhet duke vlerësuar nevojat e personit. Ky është një shërbim falas dhe respekton fshehtësinë. Megjithatë duket i vështirë, ky proces nuk është i tillë. Përfaqësuesi i ACAT (zakonisht një mjek, infermier/e, punonjës social ose punonjës tjetër shëndetësor) vlerëson situatën tuaj si dhe nevojat specifike që mund të keni.

Më pas ju informon se cilat shërbime keni të drejtë të merrni dhe se si të gjeni një shërbim që i plotëson të gjitha nevojat tuaja. Gjatë vlerësimit ju mund të merrni me vete edhe një mik apo të afërm. Gjithashtu keni të drejtë që t'i kërkonti ACAT që të marrë edhe një përkthyes nëse keni nevojë. Nëse nuk jeni të kënaqur me rezultatin e vlerësimit, ju keni të drejtë që të apelon vendimin e marrë. Për t'u vlerësuar, ju mund t'i kërkonti mjekut tuaj që t'ju rekomandojë ose që t'i telefonojë Qendrës së Lidhjes së Komonuelthit për Ndhmë në 1800 052 222.

## Fees & Charges

The cost of receiving aged care services is based on a person's assessed care needs and their ability to pay. Special consideration is given to people who are financially disadvantaged. It is important to know that you will not be denied access to a service if you are unable to pay. All people receive the same quality of care regardless of the level of fees paid. To find out more about fees and charges, contact the Aged and Community Care Information Line on 1800 500 853.

## Your Rights & Responsibilities

Aged care service providers are obliged to inform you of your rights and responsibilities regarding the services you are receiving. Whether you are receiving Residential Care or Community Care, it is important to be aware of your rights, which include the right to:

- Be informed about your rights;
- Be involved and informed about all decisions related to your care;
- Be in charge of your life, your money and your possessions;
- Be treated with dignity and respect;
- Continue your cultural or religious practices and retain the language of your choice without discrimination;
- Good quality care that meets your needs;
- Complain and take steps to sort out any problems;
- Privacy.

## Pagesa dhe Tarifa

Kostoja e kujdesit për të moshuar varet nga lloji i kujdesit që nevojitet si edhe aftësia që ka personi i vlerësuar për të paguar. Konsideratë e veçantë i jepet atyre personave që janë në gjendje të vështirë financiare. Ka shumë rëndësi që të mbani mend se edhe në se nuk jeni në gjendje që të paguani, shërbimi nuk do t'ju refuzohet. Çdo njeri merr të njëjtin shërbim pavarësisht nga sasia e pagesës. Në se dëshironi më shumë informacion në lidhje me pagesat dhe tarifën, kontaktoni Linjën e Informacioneve me Telefon për Kujdesin për të Moshuar në Komunitet (Aged and Community Care Information Line) në 1800 500 853.

## Të Drejtat dhe Përgjegjësitë tuaja

Shërbimet e Kujdesit për të Moshuar kanë për detyrë që t'ju informojnë në lidhje me të drejtat dhe përgjegjësitë që keni kundrejt shërbimit që merrni. S'ka rëndësi në se merrni Kujdes në Shtëpitë e Kujdesit për të Moshuar ose në Komunitet, është me rëndësi që ju të dini se çfarë të drejtash keni. Të drejtat tuaja përfshijnë:

- Të drejtën për t'i informuar për të drejtat tuaja;
- Të drejtën për të marrë pjesë në vendim marrje dhe për t'u informuar për të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me kujdesin tuaj;
- Të drejtën për të vendosur për jetën tuaj, për paratë dhe pronat tuaja;
- Të drejtën për t'u trajtuar me dinjitet dhe respekt;
- Të drejtën për të ruajtur kulturën, fenë dhe gjuhën tuaj pa kurrfarë diskriminimi;
- Të drejtën për të marrë kujdesin më të mirë sipas nevojave që keni;
- Të drejtën për t'u ankuar dhe për të zgjidhur problemet;
- Të drejtën e fshehtësisë.

For more information about your rights and responsibilities regarding aged care services, contact the National Aged Care Advocacy Line on 1800 700 600.

## Concerns and Complaints

If you have a concern or complaint about the quality of care or services you are receiving, you may like to discuss this with the Manager of the aged care service. If you are uncomfortable doing this, or you do not like how your complaint has been handled, you can contact the Aged Care Complaints Investigation Scheme on 1800 550 552. This is a free and confidential service.

Për më shumë informacion në lidhje me të drejtat dhe përgjegjësitë tuaja tek shërbimet e kujdesit për të moshuar, telefononi tek Linja Kombëtare e Mbrojtjes së Interesave të të Moshuarve nën Kujdes (National Aged Care Advocacy Line) në 1800 700 600.

## Shqetësimet dhe Ankesat

Në se keni ndonjë shqetësim apo ankesë në lidhje me cilësinë e kujdesit apo shërbimit që ju jepet, ju mund të bisedoni me Drejtorin e shërbimit të kujdesit për të moshuar. Në se nuk jeni të gatshëm që t'a bëni këtë, ose në se nuk ju pëlqen mënyra se si po trajtohet ankesa juaj, ju mund të kontaktoni Skemën e Hetimeve të Ankesave për Kujdesin e të Moshuarve në (Aged Care Complaints Investigation Scheme) 1800 550 552. Ky shërbim është falas dhe respekton fshehtësinë.

## Useful Contact Numbers

If you need an interpreter to help you to communicate over the phone, call the **Translating and Interpreting Service** on **13 14 50**.

This is a free service. Note that calls to numbers beginning with '1800' are free, except when made from mobile phones.

### **Aged Care Complaints Investigation Scheme: 1800 550 552**

The Aged Care Complaints Investigation Scheme investigates complaints and concerns about government-subsidised aged care services, including community care, respite care and residential care. Contact the Aged Care Complaints Investigation Scheme if you have a concern or complaint about the services you are receiving. Complaints can be made anonymously. This is a free service.

### **Aged Care Information Line: 1800 500 853**

The Aged Care Information Line provides information about aged care services, including information on fees and charges, incoming testing and financial assistance.

## Numra të Dobishëm Telefonikë

Në se keni nevojë për ndihmën e një përkthyesi për të komunikuar përmes telefonit, ju mund t'i telefononi **Shërbimit të Përkthimeve (Translating and Interpreting Service)** në **13 14 50**. Ky shërbim është falas.

Shënim: Të gjitha telefonatat e bëra tek numrat që nisin me '1800' janë falas, përveçse në se ato bëhen me anë të telefonit celular.

### **Skema e Hetimeve të Ankesave për Kujdesin e të Moshuarve (Aged Care Complaints Investigation Scheme): 1800 550 552**

Skema e Hetimeve të Ankesave për Kujdesin e të Moshuarve heton ankesat dhe shqetësimet që kanë lidhje me shërbimet qeveritare të kujdesit për të moshuar, duke përfshirë kujdesin në komunitet, pushimin nga kujdesja dhe kujdesin në banesat për të moshuar. Kontaktoni Skemën e Hetimeve të Ankesave për Kujdesin e të Moshuarve në se keni ndonjë ankesë apo shqetësim në lidhje me shërbimin që merrni. Ankesat mund të bëhen edhe në mënyrë anonime. Ky shërbim është falas.

### **Linja e Informacionit për Ndhmën për të Moshuar (Aged Care Information Line): 1800 500 853**

Linja e Informacionit për Ndhmën për të Moshuar jep informacione për shërbimet e kujdesit për të moshuar, informacione për pagesat dhe tarifaf, provat e të ardhurave dhe ndihmën financiare.

### **Centrelink - Disability, Sickness and Carers: 13 27 17**

Call this number for disability, sickness and carer enquiries, including Disability Support Pension, Mobility Allowance, Carer Payment, Carer Allowance and Sickness Allowance.

### **Centrelink - Multilingual Call: 13 12 02**

Call this number to speak to Centrelink employees in your preferred language.

### **Centrelink - Retirement Services: 13 23 00**

Call this number for retirement enquiries, including Age Pension, Pensioner Concession Cards, Commonwealth Seniors Health Card, and for enquiries regarding income assessment for residential care fees. You can also call this number to access Centrelink's Financial Information Service, which is a free and independent service available to everyone in the community (even if you are not receiving a pension or benefit).

### **Centrelink - Paaftësitë, Sëmundjet dhe Kujdestarët: 13 27 17**

Telefononi tek ky numër ku keni pyetje për paaftësitë, sëmundjet dhe kujdestarët, duke përfshirë Pensionin për të Paaftët (Disability Support Pension), Pagesën për Zhvendosje (Mobility Allowance), Pagesën për Kujdestarë (Carer Payment), Pagesën Shtesë për Kujdestarë (Carer Allowance) dhe Pagesën Shtesë për Sëmundje (Sickness Allowance).

### **Centrelink - Telefonata në Gjuhë të Huaja: 13 12 02**

Telefononi tek ky numër për të folur në gjuhën tuaj me punonjësit e Centrelink.

### **Centrelink - Shërbimet për Pensionistë: 13 23 00**

Telefononi tek ky numër për të gjitha pyetjet që kanë të bëjnë me pensionet duke përfshirë Pensionin e Pleqërisë (Age Pension), Kartat e Konçesionit për Pensionistë (Pensioner Concession Cards), Kartat Shëndetësore të Komonuelthit për të Moshuar (Commonwealth Seniors Health Card) dhe për pyetje që kanë të bëjnë me vlerësimin e të ardhurave për qëllimin e caktimit të tarifave të kujdesit për të moshuar. Në këtë numër mund t'i telefononi Shërbimit të Informacionit Financiar të Centrelink (Centrelink's Financial Information Service), një shërbim falas dhe i pavarur për të gjithë (edhe në se nuk merrni pension apo pagesë nga Centrelink).

### **Commonwealth Carelink Centre: 1800 052 222**

The Commonwealth Carelink Centre provides a single point of contact for information about aged care services. Contact the Commonwealth Carelink Centre to find out what aged care services are available in your area or anywhere in Australia, as well as information on costs, assessment procedures and eligibility criteria. This is a free and confidential service.

### **Commonwealth Carers' Respite Centre: 1800 059 059**

The Commonwealth Carer Respite Centre coordinates access to respite services in your local area, provides information and advice about respite options, help with organising emergency or planned respite, and financial assistance for short-term or emergency respite. This is a 24-hour service.

### **National Aged Care Advocacy Line: 1800 700 600**

Contact the National Aged Care Advocacy Line to find your local advocacy service. Advocacy services help to promote your rights in relation to aged care services and can increase your involvement in decision-making processes. These services may play an important role in supporting you through a complaint process and advising you of your 5 rights in negotiations with aged care service providers. This is a free and confidential service.

### **Qendra e Lidhjes së Komonuelthit për Ndhimë (Commonwealth Carelink Centre): 1800 052 222**

Qendra e Lidhjes së Komonuelthit për Ndhimë është qendër kontakti për marrjen e informacioneve për kujdesin e të moshuarve. Telefononi tek Qendra e Lidhjes së Komonuelthit për Ndhimë për të mësuar se cilat shërbimet ndodhen në lagjen tuaj ose në vende të tjera në Australi, informacione për koston, procedurat e vlerësimit dhe kriteret e të drejtës për shërbime. Ky shërbim është falas dhe respekton fshehtësinë.

### **Qendra e Komonulethit për Pushimin e Kujdestarëve (Commonwealth Carers' Respite Centre): 1800 059 059**

Qendra e Komonulethit për Pushimin e Kujdestarëve koordinon shërbimet e pushimit në zonën tuaj, jep informacione dhe këshilla për mundësitë e pushimit, ndihmon me organizimin e pushimit të planifikuar ose urgjent, si edhe jep ndihmë financiare afat shkurtër ose për raste urgjente. Ky shërbim është i hapur për 24 orë.

### **Linja Kombëtare e Mbrojtjes së Interesave të të Moshuarve (National Aged Care Advocacy Line): 1800 700 600**

Telefononi tek Linja Kombëtare e Mbrojtjes së Interesave të të Moshuarve për të mësuar se ku ndodhet qendra më e afërt e këtij shërbimi. Ky shërbim mbron të drejtat tuaja tek shërbimet e kujdesit për të moshuar dhe ju jep më shumë mundësi që të thoni fjalën tuaj në vendim marrje. Këto shërbime kanë një rol shumë të rëndësishëm sepse ju përkrahin gjatë procesit të bërjes së ankesave, ju këshillojnë për të drejtat që keni gjatë negociatave me shërbimet e kujdesit për të moshuarit. Ky shërbim është falas dhe respekton fshehtësinë.

## **National Dementia Helpline: 1800 100 500**

The National Dementia Helpline is a 24-hour national telephone and support service run by Alzheimer's Australia. It provides support, practical information and advice, as well as information on the full range of services provided by Alzheimer's Australia. This is a free and confidential service.

## **Linja Kombëtare e Ndhmës me Demencën (National Dementia Helpline): 1800 100 500**

Linja Kombëtare e Ndhmës me Demencën është një shërbim 24 orësh që jep ndihmë me anë të telefonit dhe drejtohet nga Alzheimer's Australia. Ky shërbim jep ndihmë, informacione praktike, këshilla si edhe informacione mbi të gjitha llojet e shërbimeve të ofruara nga Alzheimer's Australia. Ky shërbim është falas dhe respekton fshehtësinë.